



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:017555

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06197839

**C-IV-14-6907**

*Parashtruesi i Kërkesës*

S T, Gjakovë

*kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencioni Kosovar i Privatizimit- AKP (NSH “Banka Themelore e Kosovës”- Bankkos në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 24 shtator 2024 lëshon këtë:

## A K T V E N D I M

- Ankesa e ankueses konsiderohet e tërhequr.**
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 5 nëntor 2014, pranë DHPGJS, ankuesja parashtror një kërkesë për rishikimin e Vendimit (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) PRN125-0791 e padatur, lëshuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit të AKP (në tekstin e mëtutjeshëm AL), e emërtuar padi, me anë të cilës është refuzuar kërkesa e saj për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 59,580.98 (pesë nëntë pesë tetë zero nëntë tetë) Euro, për periudhën prej vitit 1990 gjer në vitin 1999, ndaj N.SH “Banka Themelore e Kosovës”- Bankkos (në likuidim).

Kërkesës për rishikim i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Me 10 korrik 2024, gjykata lëshoj një vërejtje për ankuesen mbi pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje ankuesja u informua se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Vërejtja, si më lartë, ju dorëzua ankueses me 29 korrik 2024.

Gjer me datën e lëshimit të këtij vendimi ankuesja nuk ka paguar taksat gjyqësore.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Ankuesja konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh: *Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 10 korrik 2024, gjykata përmes vërejtjes kërkoi nga ankuesja që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e saj do të konsiderohet e tërhequr nëse ajo nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankueses i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesja ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesja nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Gjykata nga gjitha arsyet e lartë cekura nuk hyri në shqyrtim të çështjes, në merita të saj.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar